



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1261/1 Prot.

Tiranë, më 04. 09. 2019

V E N D I M

Nr. 114, Datë 04. 09. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 100 rregj., datë 22.08.2019, e K. P., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të gjendjes ekonomike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se, më datë 31.12.2013 për shkak të një fatkeqësie natyrore të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë, i është djegur totalisht shtëpia dhe të gjithë orenditë brenda saj. Ky rast është verifikuar në atë kohë nga ana e komisionit të ngritur i Komunës Dajç dhe i gjithë dokumentacioni i është përcjellë Këshillit të Qarkut Shkodër. Më pas Këshilli i Qarkut Shkodër, ka përcjellë kërkesën e ankuesit së bashku me dokumentacionin përkatës për në Zyrën e Emergjencave Civile pranë Prefekturës Shkodër. Më tej nga ana e këtij institucioni i është dërguar¹ i gjithë dokumentacioni i nevojshëm Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, për të marrë një ndihmë financiare si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore.

Sipas ankuesit që nga viti 2014 e në vazhdim familja e tij nuk është trajtuar asnjëherë me ndonjë ndihmë financiare për shkak të fatkeqësisë natyrore që i ka ardhur si pasojë e zjarrit të rënë në

¹ Me shkresën Nr. 405/1 prot., date 23.04.2014

banesë. Në këto kushte, ai pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile për shkak se nuk i është dhënë asnjë ndihmë financiare, si dhe nuk i është kthyer asnjë përgjigje prej tyre. Në raport me familje të tjera të Qarkut të Shkodrës, të cilat në raste të ngjashme me të janë trajtuar me ndihmë financiare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese, për shkak të gjendjes ekonomike në të cilën ndodhet.

Në përfundim, K. P. kërkon nga Komisioneri, trajtimin e ankesës, ndalimin e diskriminimit, marrjen e masave ndaj institucionit përgjegjës dhe marrjen e dëmshpërblimit konform legjislacionit përkatës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në ankesën Nr. 100, datë 22.08.2019, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, K. P. është njohur me sjelljet diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, në periudhën **31.12.2013-28.04.2014**, periudhë kur K. P. ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e ndihmës financiare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile. Gjithashtu, ankuesi në rubrikën 5 të formularit të ankesës së paraqitur pranë Komisionerit, ka cituar se diskriminimi ndaj tij ka ndodhur më datë 28.04.2014. Në këto kushte, mbështetur në informacionin e vënë në dispozicion nga ankuesi, konstatohet se ka më shumë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit dhe më shumë se një vit që ka marrë dijeni mbi situatën diskriminuese të pretenduar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4 b/c të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së K. P., për shkak se është paraqitur më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit dhe më vonë se një vit nga marrja dijeni.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Gjendja ekonomike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)